

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

Programi LETËRSI SHQIPE



PUNIM DIPLOME

Përmbledhja “Njeriu me vete e me tjerë”

e Martin Camajt

Mentori:

Prof. Ass. Dr. Labinot Berisha

Kandidatja:

Diana Rrustemi

Gjakovë 2019

PËRMBAJTJA

FALËNDERIM.....	3
ABSTRAKTI.....	4
HYRJE.....	5
FIGURA E MARTIN CAMAJ.....	7
POEZIA DHE SUBJEKTI POETIK I CAMAJT.....	9
PERIUDHAT E NDARJES SË KRIJIMTARISË POETIKE TË MARTIN CAMAJ.....	10
Periudha e parë (klasike)	10
Periudha e dytë (paramoderne).....	11
Periudha e tretë(moderne).....	12
PËRMBLEDHJA “NJERIU MË VETE E ME TJERË”.....	13
ANALIZË E POEZIVE	
“Elegji e parë”	14
“Leni lumenjt”.....	15
“Atje ku s’na njih askush”.....	16
TË TJERËT PËR VEPRËN LETRARE TË MARTIN CAMAJT.....	17
MARTIN CAMAJ – rrëfime mbi poezinë.....	19
RIKTHIMI I MARTIN CAMAJ.....	20
PËRFUNDIMI.....	21

FALËNDERIM

Në momentin kur përfundova punimin, kuptova se pa ndihmën e nevojshme, ky punim do të ishte thuajse i pamundur. Në këtë këndvështrim, është një detyrim moral dhe jo formalitet, falënderimi i atyre personave që më kanë ndihmuar përgjatë gjithë punës time.

Së pari falënderoj mentorin tim Prof. Ass. Dr. Labinot Berisha, i cili me kontributin e tij shkencor dhe metodik, më ka qëndruar pranë, më ka këshilluar, ndihmuar dhe nxitur gjatë gjithë periudhës së punës për realizimin e këtij punimi.

Faleminderit për të gjithë ju profesorë për kontributin e dhënë për formësimin tim shkencor gjatë këtyre viteve te studimeve në universitetin tonë.

Falënderoj gjithashtu familjen, kolegët dhe të gjithë ata që më ndihmuan dhe më qëndruan pranë.

ABSTRAKTI

Në punimin tim të diplomës “Njeriu me vete e me tjerë” të Martin Camajt është paraqitur krijimtaria e poetit, bota e tij poetike dhe periudhat (fazat) në të cilat është zhvilluar poezia e tij.

Moraliteti i poezisë tek Martin Camaj i nënshtrohet tradicionalitetit, individualizimit dhe subjektivizmit, pra ai bazohet vetëm në pikëpamjet dhe mendimet e veta vetjake.

Bota shpirtërore e poezive të Camajt është sinonim i botës së amshuar e cila është e përjetshme, po aq sa është edhe vet poezia e tij.

Karakteristikë e veçantë e poezisë së Camaj është figura gjuhësore-formale që ai përdor.

Camaj e modelon çdo akt historik të popullit, pastaj historinë e kthen në poezi dhe me vonë poezinë në lirikë.

Përdorimi i disa simboleve si p.sh. korbi, gjarpri, bualli, dallëndyshja etj., dëshmojnë që poezia e Camajt mbështetet shumë në mitologjinë shqiptare.

Karakteristikë tjetër e veçantë është fakti që me anë të thjeshtësisë ai arrin ta pasurojë poezinë e tij në variantin gjuhësor të gegërishtes.

Camaj vlerëson shumë kulturën e pasur si dhe përdorimin e figurave të ndryshme stilistike siç janë p.sh figura e metaforës, krahasimit, epitetit dhe kontrastit.

Fjalët kyçe: poezi, evoluim, emblemë, subjektiv, mjete gjuhësore.

HYRJE

Martin Camaj është një ndër figurat më të shquara të letërsisë shqiptare, i cili la pas vepra letrare, por edhe shkencore, pasi ai krahas shkrimtarisë është marrë edhe me gjuhësi. Me veprat e botuara deri me sot dhe me anë të këtij hulumtimi rreth krijimtarisë së tij do të bindemi edhe me shumë se Camaj ishte një njeri me talent të fuqishëm.

Kujtimet e së kaluarës në të vërtetë të Camajt nuk e kanë aspektin e një nostalgjie shkatërruese, por përkundrazi nënkuptojnë mallin e dashurisë së mbijetuar intimisht, e kjo është pothuajse pika esenciale për ta njohur humanitetin e tij. Pra pikërisht prania dialektike e këtij elementi i lejon frymëzimit të Camajt të kalojë mbi karakterin e përditshëm të gjërave dhe t'i fusë ato brenda një kornize më të gjerë dhe universale.

Vepra e tij letrare shënon një dukuri të rëndësishme, shfaqet polifonike: në zhanret, në stilet dhe në modelet ligjërimore që aplikoi. Shkroi e botoi disa libra me poezi, poema, romane, novela, drama. Pjesë e veprës së tij janë edhe kontributet në gjuhësi, filologji, kritikë letrare, kulturologji.

Prej mjaft vitesh drejtoi katedrën e Munihut për gjuhë shqipe, ku përgatiteshin specialistë që rrezatonin dije albanologjike. Me Mesharin e Gjon Buzukut mbrojti me sukses tezën për doktoraturë në La Sapienca të Italisë.

Në poezinë e Camajt, koha qëndron në përputhje me ritmin e poezisë, d.m.th kjo i jep ligjërimin poetik trajtën e të qenit gjithmonë në kohë. Martin Camaj është një poet lirik me faza të ndryshme të krijimtarisë poetike dhe kjo nga shkak se ka kaluar nëpër kultura të ndryshme.

Dy vëllimet e para të Camajt “Një fyell ndër male” 1953 dhe “Kënga e vërrinit” 1954 të botuara në Prishtinë frymëzoheshin nga motivet e atdheut dhe u bënë pjesë e frymës letrare të Shkodrës.

Vëllimi “Legjenda” 1964 botuar në Itali, “Lirika mes dy moteve” botuar me 1967 në Gjermani dhe “Njeriu më vete e me të tjerë” botuar me 1978 që nxjerr në pah të gjitha mjetet stilistike e estetike dhe brenda poezisë përthyer elementin mitologjiko-modernist, ndikim ky që lidhet me kohën studentore të Camajt në Romë.

Ndërsa vëllimi i tretë përbëhet kryesisht nga ciklet Nema dhe Buelli, që janë trajtuar gjerësisht më poshtë.

Arsyeja që e zgjedha këtë temë është që të mësojmë më shumë për vlerat gjuhësore që mbart poezia letrare e Martin Camajt. Poezia e tij nuk mund të kuptohet dhe të perceptohet lehtë.

Mirëpo që e bukura e artit letrar të bëhet pronë e atij që e lexon, lypset dije, përkushtim dhe përqendrim i shtuar, prandaj që të arrihet kjo duhet bërë një analizë më e gjerë rreth poezisë së Camajt.

Synimi i hulumtimit dhe trajtimit të kësaj teme është përkujdesja ndaj poezisë letrare të Camajt, përhapja e veprave të tij dhe meqenëse është një autor jo aq i njohur për ne, hulumtimi rreth poezisë së tij është në dobi të të gjithëve.

Kjo është një përpjekje për të mbështetur letërsinë dhe kulturën shqiptare, që realizohet kryesisht me anë të ligjëratave, punimeve të ndryshme dhe me rritjen e numrit të botimit të librave.

Metodologjia e punës: Fillimisht është grumbulluar materiali i nevojshëm, pastaj tek hyrja është argumentuar qëllimi i përzgjedhjes së kësaj teme.

Në pjesën e parë flitet për krijimtarinë letrare të Martin Camajt, ku aty vihet re gërshetimi i punës së tij. Pastaj është bërë një paraqitje e shkurtër e periudhave në të cilat është zhvilluar dhe pasuruar poezia e Camajt, si dhe janë analizuar poezitë sipas evoluimit.

Janë përdorur edhe figura të ndryshme stilistike si ajo e krahasimit, kontrastit, epitetit, metaforës, simbolit, si dhe metoda e hulumtimit etj.

FIGURA E MARTIN CAMAJT

Martin Camaj u lind më 21 korrik 1925 në Telum të Temalit – Dukagjin, në Shqipërinë e Veriut, në një familje fort në zë. Në moshën gjashtë vjeçare e morën nën përkujdesje etërit jezuitë të Shkodrës, ku u shkollua në Gjymnazin klasik të tyre (në këtë gjymnaz ishin shkolluar edhe Luigj Gurakuqi, Faik Konica e shumë krijues të tjerë të shquar).

Me mbylljen e shkollave fetare në Shqipëri (1946), punoi një kohë si mësues. Si kundërshtar i sistemit komunist, për t'u shpëtuar përndjekjeve, burgut dhe torturave, më 1948 arratiset në mal. Po në këtë vit kalon kufirin ilegalisht dhe emigron në Jugosllavi. Mbas disa muajsh qëndrimi në afërsi të Podgoricës, punësohet si mësues në shkollën shqipe në Tuz.

Në shtatorin e vitit 1948 regjistrohet në Universitetin e Beogradit dhe studioi sllavistikë, romanistikë e ballkanologji. Në temën e diplomës nga albanologjia e udhëhoqi profesori i famshëm, Henrik Bariq. U diplomua më 1955.

Gjatë studimeve në Universitetin e Beogradit u njoh me student shqiptarë kosovarë dhe mori pjesë në aktivitetet e tyre kulturore, sidomos në ato letrare. Në këtë kohë edhe filloi bashkëpunimi me revista letrare të Prishtinës si “Jeta e re”, “Pioneri” etj., ku botoi krijimet e para. Qysh si student, Shtëpia botuese “Mustafa Bakija” ia botoi përmbledhjen e parë me poezi *Nji fyell ndër male* (1953), ndërsa një vit me vonë *Kënga e vërrinit*.

Qëndrimi i tij në Beograd, bashkëpunimi me revista dhe pjesëmarrja në jetën kulturore në Kosovë kushtëzohet nga sigurimi shtetëror jugosllav ose duhet të bëhej bashkëpunëtor i tyre ose duhej të kthehej në Shqipëri dhe t'u dorëzohej komunistëve. Kjo e detyroi ta braktiste Jugosllavinë dhe më 1956 kalon në Itali, ku regjistrohet në Fakultetin e letërsisë dhe të filozofisë të Romës. Në kryeqytetin e Italisë boton edhe veprën e parë në prozë *Djella* (1958).

Më 15 mars 1960, në Fakultetin e letërsisë dhe të filozofisë në Romë, mbron tezën e doktoratës mbi “Mesharin” e Gjon Buzukut para një komisioni të përbërë prej 11 profesorëve (kryetar i komisionit Prof. Angelo Monteverdi, dekan i fakultetit).

Në vitin 1961 kalon në Universitetin e Munihut ku për 30 vjet, krijoi veprat e tij më të rëndësishme në fushën e letërsisë dhe të gjuhësisë, duke filluar nga romani *Rrathë* (1978), *Albanian Grammar* (1984) e deri te përmbledhja e fundit me poezi *Palimpsest* (1991).

Në gusht të vitit 1991, mbas gati dyzet vitesh, u kthye në Prishtinë, ku mori pjesë në Seminarin e kulturës shqiptare dhe u shpall anëtar nderi i Shoqatës së shkrimtarëve të Kosovës. Mbas kësaj vizite, në Prishtinë iu botuan dy vepra: *Pishtarët e natës* (1990) dhe *Në hijen e gjarpnit* (1991) me të cilat u kthye përsëri në jetën letrare të Kosovës.

Falë punës dhe zotimit të tij Katedra e gjuhës dhe e letërsisë shqiptare në Universitetin e Munihut u ngrit në atë rang, ku mund të merreshin të gjithë titujt padagogjiko- shkencorë.

Camaj mori pjesë në shumë takime e tubime shkencore me karakter ndërkombëtar dhe kurdoherë e prezantoi në mënyrë të denjë albanologjinë.

Camaj pati letërkëmbime dhe takime me një numër të madh intelektualësh në Evropë dhe në Amerikë. Shtëpia e tij në Langgries vërtet ishte shndërruar në një qendër të rëndësishme të kuvendimeve e këmbimeve të përvojave shkencore në fushën e albanistikës.

Vdiq në Lenggries më 12 mars 1992.

Në vitin 1993 në Lenggries u themelua Shoqata “Martin Camaj”, nëpërmjet së cilës synohet afirmimi dhe njohja e letërsisë shqiptare në qarqe kombëtare dhe ndërkombëtare.¹

“Më lexoni, pastaj më gjykoni”² - ishte kërkesa e tij më e madhe ndaj popullit shqiptar. Ndërsa pak para se të jepte lamtumirën e fundit nga kjo botë, me anë të një letre testamenti i falënderoj të gjithë atdhetarët që e kishin vlerësuar veprën e tij dhe ju drejtohej duke ju thënë: **“Ndonëse të ndam për gjysmë shekulli, unë jam i jueji e ju jeni te mijtë!”**

¹ Anton Berisha, “*Vepra letrare e Martin Camaj*”, Princi, Tiranë, 2010, fq. 227.

² Po aty. fq. 203.

POEZIA DHE SUBJEKTI POETIK I CAMAJT

Martin Camaj është poet lirik me forma e përmbajtje moderne, me faza të ndryshme të krijimtarisë poetike dhe kjo nga shkak, sepse ka kaluar nëpër kultura të ndryshme. Një karakteristik themelore e poezisë së Martin Camajt është prania e një simbolike të thellë, rrezatuese e polisemike. Poezia është e shkruar në variantin e gegërishtes letrare, ka fjalor të përzgjedhur, varg të lirë dhe rimë të brendshme.

Nga faza e dytë e deri në fund poezia e Camajt ishte meditative, me disa rrafshe emocionale e kuptimore. Atë e karakterizon themeli i saj natyralist, ku kujtesa e vjetër ndërthuret me ndodhitë e jetës së përditshme.

Me vargjet e tij Martin Camaj na shfaqet si poeti shqiptar më evropian më rrënjët nga bota e pasur me mite e legjenda. Poezia e tij është si një lloj muzike e cila ballafaqohet me metodat dhe mënyrat shprehëse të lirizmit evropian e perëndimor, pranë poetëve më të mëdhenj të shekullit tonë.

Gjuha është e drejtpërdrejtë, që riprodhon emocione e përfytyrime në të gjitha rrafshet. Ajo mban mbi vete epikën, lirikën dhe veçanërisht dialektin e saj verior. Gjuha e Camajt për nga drejtshkrimi e trajtat gramatikore është një gegërishte letrare e kodifikuar.

Ajo që duket tipike e Camajt është ndjeshmëria e kontrastit siç kemi shembullin tek poezia “Ngjyra e korbit”: *“sqepi i dukej i verdhë, gati i bardhë
mes mendlave të zeza”*³

Po ashtu Camaj rëndësi i kushton edhe rendit simbolik p.sh kemi “motivin e gurit”⁴ tek poezia “Mospërfillje”, ku aty orët dhe shpirtrat e malit që janë aq të dashura për poetet shqiptarë e transformojnë në një gur-një bari me gjithë tufën.

Pastaj kemi “motivin e gruas”⁵, i cili i shërben për të ikur nga vetmia, por jo në kuptimin e dorëzimit banal të ndjenjave sepse poezia e Camajt karakterizohet me një distancë të veçantë nga aspektet vulgare të realitetit.

Kemi edhe motivin e ankthit, kërcënimit dhe motivin e dhembjes për gjërat më të dashura që duhet gjithsesi t’i braktisim, e këto elemente po të mos përcilleshin nga figura e ironisë do t’i jepnin veprës një ton pikëllues, sepse qëllimi i ironisë është të ofrojë ngushëllim atëherë kur ndjenjave u mungon guximi për t’i përballur problemet e jetës.

Gjithashtu duhet cekur edhe një motiv tjetër mjaft të rëndësishëm që ka të bëjë me “arbëreshët”, të cilët përfaqësojnë shqiptarët e mërguar në Itali. Në këtë pikë, vuajtja e shprehur si fenomen shkrihet në mënyrë mitike në dhembje.

Në krijimtarinë poetike të Martin Camaj subjekti poetik është subjekt lirik që paraqitet konkretisht në strukturën apo ndërtimin e poemave. Kështu vargun e gjallërojnë disa nga elementet e ligjërimit poetik siç janë metafora, krahasimi, epiteti, simboli etj.

Kështu themi se “Camaj e pasuroi subjektin poetik duke përdorur shprehjet origjinale shqipe që i dhanë bukuri artit dhe lirizmit të tij”.⁶

³Antonio Guzeta, “Poezia e Martin Camajt”, Rilindja, Prishtinë, 1996, fq. 43.

⁴Po aty, fq. 44.

⁵Po aty, fq. 44.

PERIUDHAT E NDARJES SË KRIJMTARISË POETIKE TË MARTIN CAMAJ

Duke u bazuar në evoluimin, ngritjen dhe pasurimin e botës së tij poetike dallohen kryesisht tri periudha, të cilat do t'i shqyrtojmë në veçanti:

- Faza klasike apo kosovare: 1953-1967
- Faza paramoderne apo italiane: 1967-1978
- Faza moderne apo gjermane: 1978-1992

Periudha e parë

Fakti se një pjesë të jetës e kaloi në Temal – Dukagjin kjo botë la gjurmë të pashlyeshme në të, duke u bërë objekt i parë dhe i përhershëm i trajtimit artistik.

Një pjesë të mirë të poezisë së Camajt me varg të lirë, që i përket periudhës së parë, e përbëjnë lirikat erotike, nëpërmjet të cilave dëshmohen cilësitë e poetit të madh si në rrafshin e origjinalitetit të perceptimit të dukurive e të strukturimit të tekstit artistik, po ashtu edhe në rrafshin e ndjeshmërisë e të ngrohtësisë poetike që i përshkon ato.

Këto poezi shenjëzojnë pasurinë shpirtërore të krijuesit: madhështinë, zemërgjerësinë, çiltërinë, ngrohtësinë, sinqeritetin, butësinë dhe ndjeshmërinë e veçantë.

Në fazën e parë ndihet mbështetja e fuqishme në mjetet shprehëse tradicionale e folklorike. Përfshin dy vëllime me poezi.

Vëllimi i parë titullohet “Një fyell ndër male”, që e botoi në Prishtinë me 1953 dhe shënon fillimin e paraqitjes së autorit në lëmin e poezisë. Në këtë vëllim ndjehet akoma brenga për atdheun e braktisur, e ai vuan prej pamundësisë për ta parë dhe prekur edhe njëherë të vetme. Ky vëllim përbehet nga 28 këngë të ndryshme të ndërtuara nga një ton lirik dhe pasqyron jetën e ndarë në kuadra.

Një vit me pas botoi përsëri në Prishtinë, në vitin 1954, vëllimin e dytë “Kënga e vërrinit”. Sipas disa studiuesve kjo fazë e krijimtarisë së Camajt la gjurmë në orientimin e traditës së re poetike ndër shqiptaret e Kosovës.

Periudha e dytë

Në fazën e dytë kemi pasurimin e elementeve shprehëse me struktura më të komplikuarra gjuhësore, duke mos u larguar assesi tharmit të motiveve vendase. Kjo periudhë përfshin tri vëllime, siç janë “Legjenda”, “Lirika mes dy moteve” dhe “Njeriu me vete e me të tjerë”. Këto

⁶Po aty, fq. 133.

përmbledhje me poezi ngërthejnë në vete elemente estetike dhe stilistike, si dhe karakterizohen nga pasurimi i strukturës gjuhësore.

Në këto vëllime imazhet poetike janë të pasura dhe shpesh tronditëse, ndërsa mendimet shprehen mbi bazën kontrastike por që nuk i nënshtrohen as një modeli të caktuar. Baza kontrastike zbatohet gjatë ballafaqimit të dukurive të ndryshme, që lidhen qoftë me fatin ose fatkeqësinë individuale, qoftë me qeniet mitike apo me simboliken e tyre që ka funksion të shumëfishtë. Bota fizike e cila në vëllimet e para kishte vëmendjen maksimale, tash zvogëlohet ndjeshëm. Edhe pse pasurohet me elemente stilistike e gjuhësore, ai as në këtë periudhë nuk i largohet tërësisht tharmit të motiveve nga vendlindja e tij.

Përmbledhja poetike “*Njeriu me vete e me tjerë*” përbëhet nga dy cikle: “Këngët e vjetra” dhe “Pleqnime me vete”. Secili varg i kësaj poezie ka një kuptim të fshehtë, p.sh autori dhimbjen nuk e përcjell direkt tek lexuesi por e zbërthen emocionalisht nëpër gjithë tekstin. “Në këtë vepër autori synon përsosmërinë formale të poezisë duke ndjekur traditën tërthorazi, pra jo në mënyrë të drejtpërdrejtë”.⁷

Gjuha në këtë poezi është mjaft e përpunuar dhe kërkon zotërimin e të menduarit, të lexuarit dhe të një kulture sa më të gjithëdijshme.

Periudha e tretë

Poezitë e Martin Camajt të përfshira në vëllimin “Nën hijen e gjarpnit” janë në të vërtetë dy ciklet poetike Nema dhe Buelli që për herë të parë u botuan me 1990 në gjuhën shqipe. Janë ndër ciklet më unike dhe më artistike të shkruara shqip. Ciklet “Nema” dhe “Buelli” si dhe përmbledhja “Palimpsest” e botuar në New York me 1991 i përkasin periudhës së tretë të krijimtarisë poetike të autorit.

Në to Martin Camaj ka shkrirë aftësinë dhe përvojën krijuese mbi dyzet vjeçare. Në këto cikle Camaj ka dëshmuar shkallën më të lartë të artit të vet, duke paraqitur sublimime poetike të shprehura në rrafshin thellësor.

Në këtë vëllim përparësi i është dhënë shprehjes, mesazhit poetik, shenjave dhe parabolave kuptimore. Gjuhen e cilëson shkalla e lartë e simbolikes dhe e abstraksionit si dhe ndërlihdja e brendshme e rrafsheve kuptimore me ç’rast bëhet prerje sinkronike e botës dhe jetës shqiptare.

Autori e shpreh rolin e mitologjisë në raport me përditshmërinë, e zhvendos kuptimin tradicional të magjive e të miteve dhe mbi bazën e tyre rindërton kuptime te reja.

“Figura e Nemës nënkupton shqetësimin, zhgënjimin, gjendjen e pazakontë, fatkeqësinë dhe mjerimin, ndërsa Buelli nuk simbolizon vetëm të keqen siç është p.sh dhuna, por simbolizon edhe të mirën”.⁸

Këto dy cikle paraqesin boten tonë, fatin e fatkeqësinë, krenarinë e tragjiken, shqetësimin e poetit, ndjesitë dhe qëndrimin e tij ndaj të kaluarës dhe të tashmes. Pra, kjo poezi është njësim i modernes mes poezisë tradicionale dhe bashkëkohëse, e cila shpreh shpirtin sa te qetë e të

⁷ Anton Berisha, “*Vepra letrare e Martin Camaj*”, Princi, Tiranë, 2010, fq .46.

⁸Po aty, fq. 61.

hareshëm, po aq të shqetësuar, fatkeq e tragjik. Poezitë në këtë vëllim i cilëson drejtpeshimi, stabiliteti, ritmi dhe rima e brendshme.

Cikli Nema – Nema këtu nuk shprehet si mallkim i drejtpërdrejtë, pra nuk është nëmë e jetës. Në të vërtetë ajo shpreh pakënaqësinë, mospajtimin, fatkeqësinë dhe tragjiken. Pra, nëpërmjet nëmës kuptojmë sëmundjen, lëngimin apo protestën kundër hijes së gjarprit, kundër mordjes, kundër vetmisë etj.

Meqenëse Nema lind dhe përtërihet gjithmonë, duke kaluar nga një individ në tjetrin, nga një brez tek tjetri, atëherë themi se ajo është e përjetshme.

Cikli Buelli - shpalos botën e poetit dhe dramatikën si rrjedhojë e fatkeqësisë individuale apo kolektive. Mirëpo fal forcës dhe madhështisë shpirtërore të poetit shqetësimet nuk shprehen përmes mllefrit, por shndërrohen në shprehje poetike e të mendimit.

Përmes Buellit njerëzit bëhen të vetëdijshëm të ballafaqohen me pësimin nga tragjikja.

“Martin Camaj nuk e përfill gjakun apo hakmarrjen, ai është paqësor dhe i bindur se ka mundësi të ndryshme për ta përballuar të keqen”.⁹

⁹Po aty, fq. 69.

Përmbledhja “Njeriu me vete e me tjerë”

Vëllimi përmbledhës “Njeriu me vete e me tjerë” hyn në radhën më të ngushtë të vëllimeve më artistike dhe më të rëndësishme të poezisë gjithëshqiptare deri më sot. Camaj i shmanget thjeshtësisë së perceptimit dhe transponimit të objekteve artistike, i shmanget qartësisë së mesazhit dhe imazhit poetik, i bishtnon komunikimit të drejtpërdrejtë e të qartë të poezisë së tij.

Është një përzgjedhje e bërë me dijeni të autorit në fund të jetës së tij. Toni mbizotërues i këtij libri është trishtimi. Në të shfaqet nevoja e njeriut për të ndalur dhe për të rigjetur fillin e humbur të kohës së tij në raport me rrjedhën objektive nga e cila ai është shkëputur jo natyrshëm.

Njeriu synon të rizbulojë dhe të ruajë origjinën si qenie mendore dhe frymore. Ai riintegrohet kështu në kohën e brendshme të kohës së tij zanafillore, ligjësitë e së cilës prekin edhe jetën edhe pasjetën. Aty gjejmë Martin Camajn intim, të mërguar, “larg nga ata që flasin si unë”¹⁰ dhe njëherësh të rikthyer me mjetet e poezisë në vendlindjen e munguar.

Vetë autori duke bërë fjalë për poezitë e përfshira në vëllimin “Njeriu me vete e me tjerë”, thekson ndër të tjera: “*Secili titull e faqe paraqet një gjendje të posaçme: njeriu ndalet në një shej vendi e kohe, harron punën e përdites dhe rëmon në vete për të gjetë fillin e humbun te ndjesive të veta. Ngjan kështu që mbas secilit varg të fshehet nga një grimë ngashërimi*”¹¹.

Qëndrimi ndaj poezisë dhe krijimit të saj, përkatësisht shenjëzimi i konceptit të tij poetik diktohet edhe në vetë poezinë, edhe pse nuk gjendet ndonjë krijim që si i tillë do të shprehte tërësinë e programit poetik.

Kjo ndodh sepse në secilën poezi dëshmohen elemente të këtij koncepti, por me dukshëm ato shfaqen në, fjala vjen:

*Fill i gjetun, Trajtë, Nji poeti të sotem, Zgjimi i poetit.
Ulet balli e prek zembrën e lules e çelet nji bote e tane
Para tamthave të kunoruem mbi një letër
Resh të ngjyrueme në diell (...)
Poeti tret në pusin e pafund
të ngyrave sig rune e si diell.*¹² (Zgjimi i poetit)

Në poezinë e kësaj periudhe ai i kthehet fatit dhe dramës së atdheut, që janë të lidhura ngushtë me fatin dhe me dramën e tij; i kthehet imazhit klasik – fëmijërisë dhe vendlindjes, Dukagjinit, Shqipërisë së Veriut: prapë merret me të kaluarën dhe të tashmen, me pësimet dhe me fatkeqësitë, por të vështruara nga një poezi të brendshme.

Pra, nëpërmjet poezisë, Camaj bën një dialog dhe një monolog me vete e me të tjerë, nëpërmjet të cilit shprehet dramatikja e botës – *si vlon mendimi i ngujuem në rrashtë*. Me strukturën gjuhësore artistike Camaj krijon një botë të veçantë, një botë magjike, që si e tillë

¹⁰ Anton Berisha, “*Vepra letrare e Martin Camaj*”, Princi, Tiranë, 2010, fq. 56.

¹¹ Po aty, fq. 51.

¹² Po aty, fq. 54.

bëhet e amshueshme. Nëpërmjet poezisë, ai gërmon në brendinë e gjërave, zbulon marrëdhëniet dhe varësinë ndërmjet dukurive e kuptimeve më të thella dhe ndihmon njohjen më të plotë.

Me forcën e fjalës së vet, poeti prek zemrën e lules dhe zbulon një botë të tërë, zbulon dhe na bën t'i njohim fshehtësitë më të mëdha, më të pazakonshmet.

I

Elegji e Parë

*Ku kam me qene i këputun
nga mundi i vjetve të rrepita sa 'i shkamb,
mos të vijë keq ty, Taze, për mue
të shtrime mbi drrasat e vdekjes,
kingj i gatuem për flije.
Leni plakat të qajnë mbi mue at dite
për njerzit e vet, vdeke qysh kur.*

*Edhe një amanet, moj grue:
kur vdiq im atë, preme dy që
me ngimun te unshmit e thneglat e lamit
me grimca buke.
Por une do të vdes mes njerzve gjithmonë
të ngishem,
prandej ndër dreket e mija qitni
vetem kafe të idhta.*

Me këtë poezi ndoshta nis epoka e pjekurisë artistikë të Camajt drejt modernitetit, gjuhës së kursyer dhe të shumëkuptimshme. Si në shumë poezi të tjera edhe këtu ndjehet ankthi i ndeshjes së dy kohëve dhe hapësirave: Fëmijëria në malësitë e Shqipërisë dhe së fundi vdekja në malësitë e Gjermanisë se jugut.

Duket se autori drejton dy amanete njëherësh: një në atdheun e largët (Tazes) dhe një në vendbanimin e përkohshëm (Gruas). Do të jenë dy ceremoni mortore në të njëjtën kohë: një në Dukagjin me plakat dhe elementet e tjera autoktone dhe një tjetër në mërgim mes njerëzve gjithmonë të ngishëm.

Poezinë e zotëron një ndjeshmëri e madhe muzikore dhe ritmike dhe pse e shkruar me vargje krejtësisht të lira e me struktura tregimtare. Ajo është një elegji moderne, ku elementet autoktone dhe primitive tentojnë të universalizohen e të bëhen të kuptueshme për të gjithë.

Ky në përgjithësi është dhe çelësi i gjithë poezisë së Camajt.

II

Leni Lumejt

*Leni lumejt te derdhen te gjithë ne Adrië
dhe ne detin Jon
e rrezja te lodroje me vale
per kenaqje te zemres e te mendes sone.
Vashat t'i lagun kambet n'uje
para syve tone te qarte.*

*Ngjyra e grunit dhe e ullinit
t'u shihet ne faqe e ne bebezat e synit
dhe kulmi i shpise te jete bungu e pragu guri.*

Tek poezia “Leni Lumenjtë” që është marrë nga vëllimi “Lirika mes dy moteve”, autori duke u shprehur me vargun e lirë shpreh këndshëm dëshirën për bashkimin e gjithë lumenjve me ç’rast lumenjtë simbolizojnë të gjitha vendet e ndara të Shqipërisë.

Këtë e shpreh bukur kur thotë:

*“Leni lumenjtë të derdhen të gjithë në Adrië
dhe në detin Jon.”*

Dhe kështu me rrezet e diellit simbolizon lumturinë që vjen si pasojë e bashkimit dhe kënaq zemrat dhe mendjet e shqiptarëve.

*“ e rrezja të lodroje me vale
për kënaqje të zemrës e të mendes sonë.”*

E kështu autori dëshiron që atë liri ta gëzojnë edhe vashat, që me një fjalë përfshin gjitha femrat shqiptare të cilat “duke lagur kambët n’uje” t’a shijojnë lirinë, madje edhe para syve të burrave.

*“Vashat t'i lagun kambet n'uje
para syve tone te qarte.”*

Duke përdorur figurat e krahasimit autori krahason ngjyrën e grurit me dritën që shihet në fytyrat e vashave dhe ngjyrën e ullirit që shkëlqen si sytë e tyre:

*“Ngjyra e grunit dhe e ullinit
t'u shihet ne faqe e ne bebezat e synit.”*

Ndërsa në vargjet e fundit na lë të kuptojmë se shqiptaret edhe po të jetojnë në një kasolle me kulm druri sipër e prag guri ju mjafton veç të jetojnë të bashkuar.

E gjithë poezia ndërtohet mbi figurën e alegorisë ku gjersa autori përshkruan natyrën dhe lumturinë e njerëzve prek edhe temat e kombësisë. Mirëpo në të njëjtën kohë ai na bën të kuptojmë se shqiptaret e donin edhe natyrën dhe lidhja e tyre me të është sikur lidhja e lumenjve me detet.

III

Atje ku s'na njeh askush

*“Si me ia ba me qene
kiterr tash para dimnit
tash qe kemi nje anderr
te dy
pa ngjyre,pa fund e maje
t'i kapemi fillit te trungut
perpjete kunder rrezeve
pa mbeshteje ne dege*

*Bashke te bahemi
unaze, kokerr,nje vize,ne qiell”.*¹³

Kjo poezi i takon periudhës së tretë të krijimtarisë së Camajt dhe është marrë nga cikli “Nema”. Në këtë poezi të titulluar “Atje ku s'na njeh askush” autori shihet të jetë i dashuruar dhe kërkon një vend ku s'ka njeri të shkojë me të dashurën e tij.

Nga fjalët e tij “tash para dimnit” kuptojmë se dashuria tyre është në fillet e para prandaj ai kërkon të bëhet kitër e të realizojë ënderren e tyre të pangjyrë e të pafund e kështu duke u ngjitur të përballet me sfidat e jetës që për të janë stina e dimrit, mirëpo çdo herë pa u mbështetur askund.

Në këtë rast autori përdor *simbolin* duke simbolizuar jetën me trungun, sfidat me rrezet dhe degët me ata të cilët mund të mbështetet por që nuk ka dëshirë, sepse dëshira tij e vetme është që të bëhej “një” me të dashurën e tij.

Ndërsa sa i përket strukturës se poezisë poeti përdor *vargun e lirë*, si duket vetëm në këtë mënyrë ai mund të shpreh vrullin e emocioneve që i dhuron dashuria.

¹³ Martin Camaj, “Në hijen e gjarpnit”, Rilindja, Prishtinë, 1991, fq.30.

Të tjerët për veprën letrare të Martin Camaj

Dushko Vetmo (Françesko Solano);

Proza e Koliqit është menduar, e studiuar, ajo e Martinit është më spontane. Martini ishte poet, pa tjetër. Më i mirë se prozator, po është e vështirë ta përkthesh atë. Kam bërë disa përpjekje për ta përkthyer ndonjë pjesë. Kisha përkthyer një vëllim të tij me poezi në italisht e ai më tha ta përktheja edhe Dranen. Del, po është e vështirë. Domethënë se është aq i njësuar gjuha me mendimin sa është e vështirë ta shprehesh në një gjuhë tjetër.

Wilfried Fiedler:

Gati askush si Camaj nuk qe i vendosur, që tri pjesët e botës shqiptare (Albanertums) – Shqipërinë, Kosovën dhe diasporën arbëreshe të Italisë – ta njohë thellësisht dhe në krijimtarinë e vet te gjakojë sintentizimin: në Shqipëri u rrit, në Prishtinë botoi përmbledhjen e tij të parë me poezi *Nji fyell ndër male* (Eine Flote im Gebirge, 1953), me të cilën më vonë te shqiptaret e Kosovës dhe marrja me arbëreshët e Italisë dhe me gjuhën e tyre e shpuri në majat e zhvillimit të tij shkencor.

Ismail Kadare:

Është një nga shkrimtarët më të mëdhenj shqiptarë të këtij shekulli (...) Vepra e tij do të jetë një faktor stabiliteti në letërsinë e sotme shqipe.

Hasan Lekaj:

Martin Camaj me opusin e tij letrar në tanësi asht kangtar i tokes shqiptare dhe i Shkodres në veçanti, asht përshkruar dhe medituës i thelle i ndjenjave dhe i pasioneve të mëdha njerëzore... Dhe ajo që asht ma thelbësore për mue asht fakti se Martin Camaj asht shkrimtar me horizont të madh psikologjik, madje asht një fenomen i rrallë në letërsinë tonë moderne.

Rudolf Marku:

Rreth Camajt dhe veprimtarisë së tij krijuese, diktatura vendosi një heshtje mbytyëse. Ndonëse krijimtaria poetike e Camajt ishte ndër ma të fuqishmet, ma të bukurat, ma shprehëse e ma modernet e letërsisë bashkëkohore shqipe, ajo u injorizua totalisht. Tue mos qenë në gjendje të kuptojë dhe të shijojë poezinë e vërtetë, atë që buron nga thellësia e shpirtit dhe që zbulon thellësitë e shpirtit, diktatura përdori armen e ligësisë, atë të heshtjes dhe injorimit. Por kjo nuk mundi të ndodhte për një kohë të gjatë, sepse meritat e Martin Camajt janë të një frymëmarrje të jashtëzakonshme.

Robert Elsie:

Krijimtaria letrare e Camajt gjatë një periudhe dyzetepesëvjeçare kalon nëpër disa faza zhvillimi. Ajo nis me poezi, gjini së cilës i mbeti besnik gjithë jetën, por më pas iu kushtua për herë e me tepër prozës.

Vehap Shita:

Dy herë i ikur dhe i larguar nga atdheu, Martin Camaj jetoi e vdiq i përvëlur për atdheun... Nuk di kur dhe si u largua Martini nga Shqipëria në moshën e tij më të re. Por e mbaj mend mirë, kur nisi t'i shprishej çerdhja edhe në Kosovë, në atdheun e tij të dytë. Si student e diplomant që nga viti 1951 ishte njeri nga bashkëpunëtorët e rregullt të "Jetës së re". Poezitë e tij të bukura më një sens të shquar romantik e dashuri të ndjeshme për vendin, popullin, atdheun, njeriun e natyrën, bukuritë e saj e të jetës – shumë shpejt e përvetësuan lexuesin shqiptar për të cilin "Jeta e re" ishte atëherë thujse e vetnja literature shqipe.¹⁴

¹⁴ Anton Berisha, "Vepra letrare e Martin Camajt", Princi, Tiranë, 2010, fq. 153.

MARTIN CAMAJ - rrëfime mbi poezinë

"Rrefej se kam pasë gjithnjë vështirësi, një lloj turpësi të flas për poezinë time apo të lexoj vargje të mia para tjerëve. Kisha gjithnjë përshtypjen se po zbuloj diçka intime a fshehtësi dhe se po humb "fillin e gjetun", drejtpeshimin e krijimtarisë.

Por meqenëse se kjo ashte e para herë që botohet diçka prej meje në vendin tim, e ndiej për detyrë t'i jap disa njoftime lexuesit të këtij libri rreth veprës sime letrare: shikue drejtas, ajo ndahet në periudha përkatësisht me fazat e jetës së një njeriu.

Ndonëse periudhat ndryshojnë nga njëra tjetra, ato ndërlidhen nga fije të forta sikur të ishte një libër i vetëm nja 2000 faqesh. S'ka pase programime në këtë krijimtari prore e percaktueme nga koha, si ashte titulli i një cikli lirikash të Giuseppe Ungareti "Giorno dopo giorno" (prej dite në tjetrën), poeti italian që ka njoftë dhe ai mërgimin.

Le të flasim për poezinë! Si e ndiej unë atë, tërthoras, ndoshta jap edhe ndoj njoftim përmbi artin tim në këtë lami.

Për shembull, gjatë periudhës afër një gjysmë shekull që e përjetuem u ndeshën dy tema letrare rivalizuese, në një anë, mrekullitë e trimnitë e herojve bashkëkohore, ndërsa tjetrën shkriheshin të mbulume gacat e një zjarmi të pashueshëm, eshke e ndezun nxjerre nga eshtnat e njerzve të thyem e të mundun.

Te dy përmbajtjet, vetëmburrja e fituesit dhe vuetje njerëzore u shfaqen njekohësisht edhe në lirike. Specifikë në këtë mes ashte njëkohësia e dy rrymave letrare të papajtueshme njena me tjetren: trimni / ligeshti.

Poezia si formë lidhet për gjuhë. Poeti mërgimtar që më të vërtetë don me mbetë ashtu si ashtë merr frymë përmes gjuhës amtare dhe sheh dita ditës si fjalët e saj shyten në nënvetdijen e harrohen. Gjysma e jetës kalon në kërkimin e fjalës së vet te humbun. Ai bie në një vorbull e sillet rrethas dhe del andej kur kujtohet se bashke me të , me poetin, ka mergue edhe fjala.

Zhdërvillimi i fjalës përnjesohet me proceset e krijimit artistik që mund ta përfytyrojmë si një fryt, pjeshke, thelbi i së cilës ashte qenia njerëzore si shqiptar, për shembull. Fjala e tij me kuptime specifike perpiqet me gjuhë të ndryshme dhe mundet me iu zgjanue edhe kuptimi, natyrisht pa u zvetnue.

Kuptimi i një lirike të tillë s'ka si të përnjesohet deshtas me nacionalizmin modern apo me ideologjitë moderne dhe as me filozofinë. Ajo në vetvete ashte e shpjegushme sepse ajo lirike mbështetet në pervojne e mitit te lashtë përçue nga struktura komunikative natyrore si janë besimet popullore e fenat.

Ky lirezëm për shumë poetë mërgimtarë të letërsive të vogla, si e jona, vjen vonë, në moshë të shtyme. Ata edhe kur janë të grishun ne ndoj festë popullore ose ne ndoj darke mbërrinjë vonë,gjithkund tepër vonë! Arsyeya ashte se ata tanë jetën me torvë ne krah prej vendi ne vend, humben edhe ndijimin e kohës, mosdalimin e te sotmes me te nesërmen".¹⁵

Mynih, maj 1991

¹⁵ Martin Camaj, "Rëmime mbi poezinë", Rilindja, Prishtinë, 1996, fq.91.

“RIKTHIMI I MARTIN CAMAJ”

Fjala “rikthim” për autorin do të thotë rivlerësim i veprës gjuhësore-letrare dhe ringjallje e vlerave poetike. Pas ikjes nga Shqipëria, Camaj nuk e gëzoi më të drejtën të komunikonte me lexuesit shqiptarë, qoftë brenda apo jashtë kufijve. Por, për aq kohë sa poezia e Camajt ishte në shqyrtim, letërsia shqipe ishte bërë gjysmake e sidomos ajo bashkëkohore.

Martin Camaj kishte shkruar në dialektin e gegërishtes, pra në variantin më të hershëm të gjuhës shqipe. Por, kushedi se a përbënte pengesë për lexuesit fakti që Camaj ka shkruar në gegërisht?! Mendoj që po, madje vet stili i të shkruarit në variantin gegë paraqet vështirësi që Camaj të bëhet pjesë e vlerave letrare.

Por ai si rrallëkush vërtetoi të kundërtën, duke shpjeguar që: gjuha e letërsisë është gjuha e autorit. Kështu, poeti duke iu larguar kohës reale-sociale arrin që brenda dy dekada vitesh, nga një autor i ndaluar apo i panjohur, të bëhet një ndër personalitetet më të shquara të letërsisë shqipe.

Dhe duke u nisur nga fakti që në poezinë tij reflektoi një aristokratizëm prej fisnikërisë shqiptare kuptojmë që ai ishte njeri i pastër me veten, i cili nuk synoi të përçojë kurrfarë urrejtje përmes artit të tij, përkundrazi ai kishte për qëllim që arti tij t’i largohej strukturave tradicionale dhe të bëhej universal (i përgjithshëm).

PËRFUNDIM

Një personalitet i fuqishëm i letrave shqipe, i pajisur me një kulturë e formim filologjik, që mundi ta fitonte vetëm me çmimin e shtrenjtë të largimit nga vendlindja, Martin Camaj dha një shembull të shkëlqyer të bashkimit të punës së shkrimtarit e gjuhëtarit krijues.

Vepra tij ka nevojë të studiohet, jo vetëm për mendimet, idetë e forcën e fjalës, por edhe në aspektin gjuhësor, për fjalët e reja që krijoi e për fjalët e vjetra që futi në përdorim, për shprehjet popullore që mblodhi e përdori apo që i krijoi vetë etj.

Edhe pse jetoj dhe punoi larg Shqipërisë, ai nuk e ndërpreu lëvrimin e gjuhës shqipe. Duke qenë krijues në prozë dhe në poezi shfaqti aftësitë e tij letrare dhe gjuhësore. Për fat të keq letërsia e shkruar prej tij mbeti për një kohë të gjatë e panjohur për lexuesit shqiptar, kështu që edhe gjuha edhe përdorimi i saj nuk arriti të ketë ndikim tek gjuha e njerëzve.

Figura e Martin Camaj si gjuhëtar dhe si shkrimtar do të vlerësohet pas shumë vitesh nga studiues të ndryshëm, pasi vepra e tij si prurje gjuhe e veçantë, u njoh nga studimet shqiptare, jo gjatë krijimit të saj, por pasi ai e kishte mbyllur ciklin e tij prej shkrimtari.

Camaj është njëri prej shkrimtarëve të rrallë shqiptarë i cili me forcën e vet intelektuale krijuese është sa i sukseshëm dhe i madh në poezi, po aq edhe në prozë.

Vepra e tij gjuhësore dëshmon për studimin që ai i bëri gjuhës shqipe, për njohjen e thellë që kishte për historinë e shqipes dhe dialektet e saj, por edhe për kontributin e madh si gjuhëtar.

Në qoftë se sipas Bleikut poezia është “alegori që u drejtohet forcave intelektuale” e gjithë vepra e Camajt është e tillë; siç do të thoshte Northrop Fraj, që “Vepra e imagjinatës na prezanton një vizion, jo të madhështisë personale të poetit, por të një gjëje jopersonale dhe shumë më madhështore; vizionin e një akti të vendosur të lirisë shpirtërore, vizionin e rikrijimit të njeriut”. Në këtë plan vepra e Camajt është shembull i rrallë në letërsinë tonë.

Vdekja e parakohshme e ndaloi që ai të realizonte ëndrrën e tij, që një ditë të kthehej në atdheun e tij të dashur, të cilit i kushtoi tërë forcat e tij.

Në fund dua të theksoj se leximi dhe ribotimi i poezive të këtij poeti aq madhor të mbetet detyrë primare për të gjithë letrarët, që në këtë mënyrë të krijojmë mundësi për njohjen dhe studimin e mirëfilltë të krijimtarisë së tij.

Literatura

1. Martin Camaj, “*Në hijen e gjarpnit*”, “Jeta e re”, Prishtinë, 1991.
2. “Jeta e Re”, *Revistë Letrare*, “Rilindja”, Prishtinë, 1996.
3. Antonio Guzeta “*Jeta e re*”, “Rilindja”, Prishtinë, 1996.
4. Anton Berisha, “*Vepra letrare e Martin Camajt*”, “Princi”, Tiranë, 2010.
5. Bardhyl Demiraj, *Jeta akademike e Martin Camaj*, “Studime shqiptare”, Shkodër, 2011.
6. Martin Camaj, “*Kanga e vërrinit*”, “Mustafa Bakija”, Prishtinë, 1954.

Burime shtesë:

<http://depts.eashington.edu/slaveeb/18BSSLLF/abstracts/17..pdf>

<http://shkoder.net/camaj-lanksch/>

<http://revistasaras.al/2015/07/21/martin-camaj-shkrimtari-i-lartesive/>

